

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara

SKK 6 PROVIZIONET, DETYRIMET DHE AKTIVET E KUSHTËZUARA

Pg.		
	STANDARDI KOMBËTAR I KONTABILITETIT NR. 6 – PROVIZIONET, DETYRIMET DHE AKTIVET E KUSHTËZUARA - I PËRMIRËSUAR	
	PËRMBAJTJA	<i>Paragrafët</i>
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES	1 - 3
	FUSHA E ZBATIMIT	4 - 6
	PËRKUFIZIMET KRYESORE	7 - 9
	NJOHJA E PROVIZIONEVE - RREGULLA TË PËRGJITHSHME	10 - 22
	Njohja e provizioneve	10-16
	Matja e provizioneve	17 - 19
	Vlerësimi i mëpasshëm i provizioneve	20
	Përdorimi i provizioneve	21 - 22
	NJOHJA E PROVIZIONEVE - FUSHAT SPECIFIKE	23-35
	Provizionet e garancisë	23
	Provizionet që lidhen me çështjet gjyqësore	24 - 25
	Provizionet që lidhen me kontrata me kushte rënduese	26 - 27
	Provizionet për detyrimet mjedisore	28 - 30
	Provizionet për kostot e ristrukturimit	31 - 35
	DETYRIMET E KUSHTËZUARA	36 - 37
	AKTIVET E KUSHTËZUARA	38 – 39
	PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E PERFORMANCËS	40 - 43
	SHËNIMET SHPJEGUESE	44 - 47
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	48
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (SNRF PËR NVM)	49
	BAZA E KONKLUSIONEVE	
	UDHËZUES PËR ZBATIMIN E SKK 6	
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES	
1	Objekti i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 6, <i>Provizionet, aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara</i> (‘SKK 6’ ose ‘Standardi’), i nxjerrë dhe miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe i shpallur nga Ministria e Financës, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të provizioneve, aktiveve dhe detyrimeve të kushtëzuara si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Këto standarde bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar.	
2	SKK 6 mbështetet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit, SNK 37 <i>Provizionet, detyrimet dhe aktivet kushtëzuara</i> . SKK 6 është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 21 – <i>Provizionet dhe detyrimet e kushtëzuara</i> të Standardeve	

	Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Njësitë e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafe të SNRF për NVM është dhënë në paragrafin 50. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 6 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare, dhe ndryshimeve të fluksit të parasë dhe të kapitalit të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin 9 të Ligjit nr. 9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, nxjerrë në prill 2004.
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 40 deri 90 të SKK 1.
	FUSHA E ZBATIMIT
4	Ky Standard zbatohet për të gjitha provizionet (p.sh. detyrimet që kanë kohën e shlyerjes dhe shumën të pasigurta), aktivet e kushtëzuara dhe detyrimet e kushtëzuara përveç atyre që mbulohen nga SKK të tjera. Këto përfshijnë provizionet në lidhje me: <p>(a) qiratë (SKK 7 <i>Kontabilizimi i qirave</i>). Megjithatë, duhet të kihet parasysh që ky Standard trajton qiratë e zakonshme të cilat kanë kontrata me kushte rënduese.</p> <p>(b) kontratat e ndërtimit (SKK 8 <i>Të ardhurat</i>).</p> <p>(c) detyrimet për përfitimet e punonjësve.</p> <p>(d) tatimi mbi fitimin (SKK 11 <i>Tatimi mbi fitimin</i>).</p>
5	SKK 6 përkufizon termin provizion dhe shpjegon ndryshimin mes një provizioni dhe një detyrimi të kushtëzuar. Standardi bën dallim mes situatave, ku njohja e një provizioni është e nevojshme të bëhet në pasqyrën e pozicionit financiar, dhe situatave kur është e mjaftueshme që të shpjegohet detyrimi i kushtëzuar, në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.
6	Termi ‘provizion’ përdoret shpesh në kontekstin e zërave të tillë si amortizimi, zhvlerësimi i aktiveve, dhe llogari të arkëtueshme të pambledhshme. Këto kanë të bëjnë me rregullimet e vlerave kontabël të aktiveve, dhe jo me njohjen e detyrimeve, prandaj ato nuk trajtohen në këtë SKK.
	PËRKUFIZIMET KRYESORE
7	Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore të përdorura në këtë standard: <p><u>Provizioni</u> është një detyrim aktual, për të cilin koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta.</p> <p><u>Ngjarja detyruese</u> është ngjarja që krijon një detyrim ligjor ose konstruktiv për njësinë ekonomike.</p> <p><u>Detyrimi ligjor</u> është detyrim që rrjedh nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> një kontratë (nëpërmjet kushteve të shprehura ose të nënkuptuara të kontratës); legjislacioni apo një akt tjetër ligjor. <p><u>Detyrimi konstruktiv</u> është detyrim që rrjedh nga veprimet e një njësie ekonomike ku:</p> <ol style="list-style-type: none"> në bazë të një modeli të vendosur nga praktikat e shkuara, politika të shpallura ose një deklarami specifik, njësia ekonomike ua ka bërë të ditur palëve të tjera se do të pranojë përgjegjësi të caktuara; si rezultat, njësia ekonomike ka krijuar një pritshmëri të arsyeshme te palët e tjera, se ajo do t’i shlyejë këto përgjegjësi. <p><u>Detyrim i kushtëzuar</u> është:</p> <ol style="list-style-type: none"> një detyrim që krijohet nga ngjarje të shkuara, ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, të cilat nuk janë nën kontrollin e plotë të njësisë ekonomike; një detyrim ekzistues që rrjedh nga ngjarje të shkuara, por që nuk është njohur pasi: <ol style="list-style-type: none"> ka mundësi që shlyerja e detyrimit nuk do të shoqërohet me dalje të burimeve ekonomike; shuma/vlera e detyrimit nuk mund të vlerësohet me saktësi të mjaftueshme. <p><u>Aktiv i kushtëzuar</u> është një kërkesë e krijuar nga ngjarje të shkuara, ekzistenca e së cilës do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, që nuk janë nën kontrollin e plotë të njësisë ekonomike.</p>
8	Provizionet mund të dallohen nga detyrime të tjera “të zakonshme” (për shembull, detyrimet për t’u paguar furnitorëve, huamarrjet etj.) pasi në to ka pasiguri mbi kohën ose shumën e shpenzimeve të ardhshme për t’u shlyer. Shuma e përdorur për njohjen e detyrimeve “të zakonshme” përcaktohet në përgjithësi nëpërmjet një fature, kontrate ose dokumenti tjetër, dhe nuk ka nevojë për një vlerësim kontabël. Për njohjen e provizioneve në pasqyrën e pozicionit financiar, për përcaktimin e shumës së nevojshme për shlyerjen e provizioneve ose afatit kohor të provizioneve, do të merret për bazë opinioni i drejtuesve ose ekspertëve të tjerë. Meqenëse vlerësimi i provizioneve bazohet në vlerësime që mund të mos jenë gjithmonë të sakta, është e rëndësishme që ato të njihen dhe raportohen të ndara nga detyrimet e tjera.
9	Pasiguria, përsa u përket detyrimeve të kushtëzuara, është edhe më e madhe sesa pasiguria në lidhje me provizionet. Nëse realizimi i provizioneve është relativisht i sigurt dhe shuma mund të vlerësohet në mënyrë relativisht të saktë, kur flasim për detyrimet e kushtëzuara, ose realizimi i tyre është i pasigurt, ose shuma nuk mund të vlerësohet me saktësi as edhe relativisht.

NJOHJA E PROVIZIONEVE - RREGULLA TË PËRGJITHSHME	
Njohja e provizioneve	
10	Njësia ekonomike do ta njohë provizionin si një detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar dhe shumën e tij si një shpenzim, përveç rastit kur një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e kostos së një aktivi si p.sh. inventar ose tokë, ndërtesa, makineri dhe pajisje.
11	Njësia ekonomike do ta njohë një provizion vetëm kur e ashtuquajtura ngjarje detyruese ka ndodhur para datës së raportimit. Që një ngjarje të quhet detyruese, është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për njësinë ekonomike, dhe që njësia ekonomike nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij.
12	Kushti i dhënë në paragrafin 11 (detyrim në datën e raportimit si rezultat i një ngjarje të kaluar) do të thotë se njësia ekonomike nuk ka alternativë tjetër realiste veçse shlyerjen e detyrimit. Kjo mund të ndodhë kur njësia ka një detyrim ligjor që mund të zbatohet me ligj ose kur njësia ekonomike ka një detyrim konstruktiv, sepse ngjarja e fundit (që mund të jetë një veprim i njësisë ekonomike) ka krijuar pritshmëri të vlefshme në palët e tjera që njësia ekonomike do ta shlyejë detyrimin. Detyrimet që rrjedhin nga veprimet e ardhshme të njësisë ekonomike (p.sh. zhvillimi i ardhshëm i biznesit të saj) nuk përmbushin kushtet në paragrafin 11, pa marrë parasysh se sa mundësi ka që ato të ndodhin edhe nëse janë kontraktuale. Për ta ilustruar, për shkak të presioneve tregtare apo të kërkesave ligjore, një njësi ekonomike mund të synojë ose të ketë nevojë për të bërë shpenzime që të veprojnë në një mënyrë të veçantë në të ardhmen (për shembull, duke vendosur filtra tymi në një lloj të veçantë fabrike). Meqë njësia ekonomike mund të shmangë në të ardhmen shpenzimet që janë pasojë e veprimeve të saj të ardhshme, për shembull, duke ndryshuar metodën e saj të shfrytëzimit apo të shitjes së fabrikës, ajo nuk ka asnjë detyrim aktual për këto shpenzime të ardhshme dhe nuk njihet asnjë provizion.
13	Në rastin e detyrimit konstruktiv nuk ka bazë ligjore, mbi të cilën kërkohet shlyerja e detyrimit. Megjithatë, njësia ekonomike, nëpërmjet veprimtarive të saj apo deklaratave specifike, ka krijuar pritshmëri të vlefshme të palët e tjera se kjo njësi do ta shlyejë detyrimin, d.m.th. mosshlyerja e detyrimit nuk ka gjasa të ndodhë.
14	Një provizion do të njihet, vetëm nëse mundësia për realizimin e tij është më e madhe se mosrealizimi i tij (d.m.th. ka më shumë gjasa se jo). Nëse mundësia e realizimit është më e vogël se mosrealizimi i tij, provizioni nuk do të njihet, por detyrimi do të paraqitet si një detyrim i kushtëzuar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.
15	Në përgjithësi është gjithmonë e mundur të bëhet një vlerësim relativisht i saktë i shumës së një provizioni të nevojshëm (d.m.th. shuma që nevojitet për shlyerjen e detyrimit). Në raste të rralla, kur nuk mund të bëhet një vlerësim i tillë, provizioni nuk do të njihet në pasqyrën e pozicionit financiar, por faktorët që lidhen me të do të përshkruhen si një detyrim i kushtëzuar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.
16	Krijimi i një provizioni të ri, ose rritja e një provizioni ekzistues, zakonisht regjistrohet si një shpenzim i periudhës kontabël. Në rastin kur krijimi i një provizioni lidhet me përdorimin ose shitjen, apo nxjerrjen jashtë përdorimit të një aktivi, shuma e një provizioni të tillë do t'i shtohet kostos së këtij aktivi.
Matja e provizioneve	
17	Shuma e njohur si provizion do të jetë vlerësimi më i saktë i mundshëm i shpenzimeve të nevojshme për shlyerjen e një detyrimi ekzistues të mundshëm, e vlerësuar kjo në datën e raportimit. a) Kur provizioni përfshin një popullatë shumash, vlerësimi i shumës së provizionit pasqyron peshën e të gjitha rezultateve të mundshme me probabilitetet e tyre përkatëse. Pra, provizioni do të jetë i ndryshëm në varësi të faktit nëse probabiliteti i humbjes për një shumë të caktuar është, për shembull, 60 për qind ose 90 për qind. Kur ka një varg rezultatesh të mundshme, dhe çdo pikë në këtë varg është po aq e mundshme sa çdo pikë tjetër, atëhere përdoret pika e mesit të vargut të vlerave. b) Kur provizioni ka të bëjë me një detyrim të vetëm, rezultati më i mundshëm mund të jetë vlerësimi më i mirë i shumës së nevojshme për të shlyer detyrimin. Megjithatë, edhe në një rast të tillë, njësia ekonomike merr parasysh edhe rezultate të tjera të mundshme. Kur rezultatet e tjera të mundshme janë kryesisht më të larta ose kryesisht më të ulëta se sa rezultati më i mundshëm, atëhere vlerësimi më i mirë do të jetë respektivisht një shumë më e lartë ose më e ulët se rezultati i mundshëm. c) Kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material, shuma e një provizioni do të jetë vlera aktuale e shumës që pritet të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin. Norma e skontimit (ose normat) do të jetë një normë para tatimit (ose normat) që pasqyron (pasqyrojnë) vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë. Rreziqet specifike të detyrimit duhet të pasqyrohen ose në normën e skontimit ose në vlerësimin e shumave të nevojshme për të shlyer detyrimin, por jo në të dyja. d) Kur provizioni shlyhet pas 12 muajve pas datës së raportimit, do të njihet me vlerën aktuale të shpenzimeve të pritshme, përveç rastit kur efekti i skontimit është jomaterial.
18	Një njësi ekonomike duhet të përjashtojë nga matja e një provizioni fitimet nga nxjerrja e pritshme jashtë përdorimit e aktiveve.
19	Kur disa ose të gjithë shumat e nevojshme për të shlyer një provizion mund të rimbursohen nga një palë tjetër (p.sh. përmes një pretendim sigurimi), njësia do ta njohë rimbursimin si një aktiv të veçantë vetëm kur është praktikisht e sigurt se ajo do ta marrë rimbursimin me shlyerjen e detyrimit. Shuma e njohur për rimbursimin nuk duhet të kalojë shumën e provizionit. Rimbursimi i arkëtueshëm do të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv dhe nuk do të kompensohet kundrejt provizionit. Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, njësia ekonomike mund të kompensojë çdo rimbursim nga një palë tjetër kundrejt shpenzimeve në lidhje me provizionin.

	Vlerësimi i mëpasshëm i provizioneve
20	Një njësi ekonomike do t'i rishikojë provizionet në çdo datë të raportimit dhe do t'i rregullojë ato për të pasqyruar vlerësi min më të mirë aktual të shumës që do të kërkohet për të shlyer detyrimin në atë datë të raportimit. Çdo rregullim i shumave të njohura më parë do të njihet në fitim ose humbje me përjashtim kur provizioni është njohur fillimisht si pjesë e kostos së një aktivi (shih paragrafin 16). Kur një provizion matet me vlerën aktuale të shumës që pritet të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin, zbritja do të njihet si një kosto financiare në fitim ose humbje në periudhën kur shkaktohet.
	Përdorimi i provizioneve
21	Një provizion do të përdoret vetëm për ato lloj shpenzimesh, për të cilat ai është njohur fillimisht.
22	Asnjë shpenzim tjetër, që nuk ka lidhje me provizionin e krijuar, nuk duhet të kompensohet kundrejt tij, pasi kjo do të dëmtonte karakterin objektiv të pasqyrave financiare të një njësie ekonomike.
	NJOHJA E PROVIZIONEVE – FUSHA SPECIFIKE
	Provizionet e garancisë
23	Në rast se njësi ekonomike jep garanci për produktet që ajo shet, në pasqyrat financiare të njësisë do të njihet një provizion i barabartë me shumën e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve të garancisë për produktet e shitura deri në datën e raportimit. Për vlerësimin e provizioneve do të merret për bazë përvoja e mëparshme.
	Provizionet që lidhen me çështjet gjyqësore
24	Njësi ekonomike do të njohë një provizion në pasqyrat financiare të saj, në lidhje me të gjitha çështjet gjyqësore ekzistuese dhe ato të mundshme, në rastet kur: a. një ngjarje detyruese, që ka krijuar çështjen gjyqësore, ka ndodhur para datës së raportimit; b. është e mundshme që njësi ekonomike të përballojë shpenzime, në lidhje me zgjidhjen e çështjes gjyqësore; c. shumën e shpenzimeve të pritshme, që lidhen me çështjen gjyqësore, mund të vlerësohet relativisht me saktësi. Nëse nuk plotësohen kushtet e lartpërmendura, provizioni nuk do të njihet në datën e raportimit, por çështjet që lidhen me gjyqin do të përshkruhen si një detyrim i kushtëzuar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.
25	Ndonëse shpesh mund të bëhet vetëm një vlerësim i përafërt i shumës që ka të bëjë me çështjet gjyqësore, kjo nuk përbën arsye për moskrijimin e një provizioni. Vetëm në raste të rralla, kur shumat që lidhen me çështjet gjyqësore mund të jenë shumën e ndryshme për skenarë të ndryshëm, dhe probabiliteti i këtyre skenarëve nuk mund të parashikohet me besueshmëri, provizioni nuk do të njihet, por një përshkrim i çështjeve gjyqësore do të paraqitet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.
	Provizionet që lidhen me kontratat me kushte rënduese
26	Kontrata me kushte rënduese është një kontratë, në të cilën kostoja e shlyerjes së një detyrimi i kapërcen përfitimet ekonomike që priten prej kësaj kontrate.
27	Një provizion për kontratat me kushte rënduese do të kontabilizohet me shumën më të vogël midis humbjes që lidhet me përmbushjen e kontratës (d.m.th. të ardhurat nga kontrata minus koston që lidhet me përmbushjen e saj) ose gjobës për pezullimin e kontratës.
	Provizionet për detyrimet mjedisore
28	Në pasqyrat financiare të saj, një njësi ekonomike do të krijojë një provizion për detyrimet mjedisore që kanë lindur para datës së raportimit nëse: a. sipas legjislacionit, kërkohet likuidimi ose kompensimi për një dëm specifik; b. njësi ekonomike ka treguar, nëpërmjet veprimtarive dhe politikave të saj mjedisore, se ajo synon ta likuidojë vullnetarisht dëmin mjedisor.
29	Për detyrimin mjedisor do të njihet një provizion i barabartë me shumën e kostove që lidhen me likuidimin e dëmit (përfshirë këtu edhe gjokat e mundshme). Nëse njësi ekonomike preferon të paguajë gjokat në vend të likuidimit të dëmit, do të njihet një provizion i barabartë me shumën e gjobave të mundshme.
30	Nëse detyrimi mjedisor ka ndodhur si rezultat i blerjes, krijimit ose përdorimit të një aktivi (për shembull një minierë), atëherë shumën e provizionit do të përfshihet në koston e aktivitetit. Kur detyrimi mjedisor rezulton në një shtesë të çmimit të blerjes së aktivitetit, njësi ekonomike duhet të analizojë nëse kjo tregon se vlera e re kontabël e aktivitetit mund të mos jetë plotësisht e rikuperueshme. Për këtë, njësi ekonomike duhet të kryejë testin e zhvlerësimit të aktivitetit, duke vlerësuar shumën e tij të rikuperueshme dhe, në përputhje me SKK 5, duhet të kontabilizojë humbjen nga zhvlerësimi.
	Provizionet për kostot e ristrukturimit
31	Ristrukturimi është një riorganizim i veprimtarisë së njësisë ekonomike, në bazë të një plani të veçantë veprimi, të zbatuar nga drejtuesit e njësisë ekonomike, si rezultat i të cilit fusha e veprimit të biznesit të ndërmarrë, ose mënyra se si kryhet ky biznes, do të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme.
32	Shembuj të ristrukturimit janë shitja ose likuidimi i një linje biznesi, mbyllja ose zhvendosja e njësisë të caktuar të rëndësishme të prodhimit, ndryshime të konsiderueshme në strukturën e drejtimit që çojnë në shkurtimin e disa prej anëtarëve të stafit drejtues e të tjera të ngjashme.
33	Kur një detyrim konstruktiv ka lindur si pasojë e një programi ristrukturimi, njësi ekonomike do të njohë një provizion, vetëm nëse njësi ekonomike, para datës së raportimit:

	<p>(a) ka një plan të detajuar zyrtar për ristrukturimin duke identifikuar të paktën:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) biznesin ose pjesën e një biznesi në fjalë; (ii) vendet kryesore që ndikohen; (iii) vendndodhjen, funksionin dhe numrin e përafërt të punonjësve të cilët do të kompensohen për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës; (iv) shpenzimet që do të ndërmerren; dhe (v) kohën kur do të zbatohet plani; dhe <p>(b) ka krijuar një pritshmëri të vlefshme tek palët përkatëse se ajo do të kryejë ristrukturimin duke filluar me zbatimin e planit ose duke njoftuar karakteristikat e tij kryesore atyre që ndikohen prej tij.</p>
34	<p>Një provizion ristrukturimi do të përmbajë vetëm shpenzimet e drejtpërdrejta që ndodhin vetëm njëherë, si rezultat i zbatimit të programit të ristrukturimit, dhe që nuk janë të lidhura me veprimtaritë e njësisë ekonomike pas ristrukturimit. Shembuj të shpenzimeve të ristrukturimit, që diktojnë krijimin e një provizioni, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. shpenzimet që lidhen me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës; b. shpenzimet që lidhen me mbylljen e një njësie prodhimi; c. shpenzimet që lidhen me kontratat që janë shndërruar në kontrata me kushte rënduese, si rezultat i ristrukturimit (për shembull, marrëveshjet e qirasë financiare që kthehen në kontrata me kushte rënduese pas ristrukturimit).
35	<p>Për shpenzimet e mëposhtme nuk do të krijohet provizion ristrukturimi, pasi ato nuk janë të lidhura me vetë ristrukturimin, por janë të lidhura me veprimtaritë e biznesit pas ristrukturimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. shpenzimet për rikualifikimin e punonjësve dhe ripozicionimin e tyre; b. shpenzimet e marketingut; c. shpenzimet që lidhen me zhvillimin e sistemeve të reja
DETYRIMET E KUSHTËZUARA	
36	<p>Detyrim i kushtëzuar është një detyrim që mund të krijohet nga ngjarje të shkuara, ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nga ndodhja ose mosndodhja e një ose disa ngjarjeve të ardhshme të pasigurta, që nuk janë nën kontrollin e plotë të njësisë ekonomike; ose një detyrim ekzistues, të krijuar nga ngjarje të shkuara, por që nuk kontabilizohet pasi nuk është e mundur që shlyerja e këtij detyrimi të shoqërohet me një dalje të burimeve; ose shuma e detyrimit nuk mund të vlerësohet relativisht me saktësi. Shembuj të detyrimeve të kushtëzuara janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. një detyrim që lidhet me proceset gjyqësore të nisura ndaj njësisë ekonomike, të cilat ajo nuk parashikon t'i humbasë; b. një kredi e marrë nga një njësi tjetër dhe e garantuar nga njësia ekonomike në fjalë, garanci që nuk pritet të shkaktojë shpenzime për njësinë ekonomike në fjalë, pasi njësia tjetër është në gjendje t'i shlyejë detyrimet.
37	<p>Detyrimet e kushtëzuara nuk do të njihen, përveç provizioneve për detyrimet e kushtëzuara të një njësie të blerë në një kombinim biznesi, por në lidhje me to do të jepet informacion në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Detyrimet e kushtëzuara, realizimi i të cilave është shumë pak i mundshëm, nuk kanë nevojë të paraqiten në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.</p>
AKTIVET E KUSHTËZUARA	
38	<p>Një aktiv i kushtëzuar është një kërkesë e mundshme që lind nga ngjarje të shkuara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, të cilat nuk janë nën kontrollin e plotë të njësisë ekonomike. Shembull i një kërkesë të mundshme është një ankesë që njësia ekonomike i ka paraqitur një njësie tjetër, realizimi i së cilës varet nga rezultati i proceseve gjyqësore.</p>
39	<p>Një njësi ekonomike nuk do të njohë një aktiv të kushtëzuar si një aktiv. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për një aktiv të kushtëzuar, në rastet kur është e mundshme një hyrje e përfitimeve ekonomike. Megjithatë, kur fluksi hyrës i përfitimeve të ardhshme ekonomike të njësisë është pothuajse i sigurtë, atëherë aktivi nuk është një aktiv të kushtëzuar dhe është e mundur njohja e tij.</p>
PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E PERFORMANCËS	
40	<p>Provizionet paraqiten duke përdorur zërat përkatës në formatin e pasqyrës së pozicionit financiar të dhënë në SKK 2, <i>Paraqitja e pasqyrave financiare</i>.</p>
41	<p>Provizionet, që priten të realizohen brenda 12 muajve pas datës së mbylljes së raportimit (p.sh. provizionet e krijuara në lidhje me proceset gjyqësore) ose gjatë ciklit normal të biznesit të një njësie (p.sh. provizionet për garancitë) do të regjistrohen në zërin "Provizione afatshkurtra" (ose te nënzërat e tij).</p>
42	<p>Provizionet që priten të realizohen me vonë se 12 muaj pas datës së raportimit (p.sh. provizionet që lidhen me proceset gjyqësore) ose për periudha më të gjata se cikli normal i biznesit të njësisë (p.sh. provizionet për garancitë) do të regjistrohen në zërin "Provizione afatgjata" (ose te nënzërat e tij).</p>
43	<p>Shpenzimet që lidhen me krijimin e provizioneve do të regjistrohen në atë zë të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, me të cilin kanë më shumë lidhje. Reduktimi i provizioneve do të regjistrohet tek i njëjti zë i pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, ku janë njohur më parë shpenzimet, në lidhje me krijimin e provizionit.</p>

SHËNIMET SHPJEGUESE																											
44	<p>Për klasa të ndryshme të provizioneve, do të jepet informacioni si më poshtë:</p> <p>a. përshkrimi i tyre;</p> <p>b. data e parashikuar e realizimit;</p> <p>c. norma e përdorur për skontimin e provizioneve afatgjata.</p> <p>d. një rakordim që tregon</p> <p style="padding-left: 40px;">(i) vlerën kontabël neto në fillim dhe në fund të periudhës;</p> <p style="padding-left: 40px;">(ii) shtesat e bëra gjatë periudhës, duke përfshirë rregullimet që rezultojnë nga ndryshimet në matjen e shumës së skontuar;</p> <p style="padding-left: 40px;">(iii) shumat e ngarkuara kundrejt provizionit gjatë periudhës.</p> <p style="padding-left: 40px;">(iv) shumat e papërdorura të anuluar gjatë periudhës.</p> <p>e. një përshkrim të shkurtër të natyrës së detyrimit, shumës së pritur, dhe afatit kohor të çdo pagesë që bëhet.</p> <p>f. një tregues të pasigurive rreth shumës apo kohës së këtyre daljeve.</p> <p>g. shumën e çdo rimbursimi të pritshëm, duke deklaruar shumën e çfarëdo aktivi që ka qenë njohur për këtë rimbursim të pritshëm.</p> <p>Informacioni krahasues për periudhat e mëparshme nuk kërkohet.</p>																										
45	<p>Për të gjitha detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara do të jepet informacioni, si më poshtë:</p> <p>a. përshkrimi i tyre;</p> <p>b. parashikimi i shumës dhe kohës së realizimit;</p> <p>c. një vlerësim të efektit të saj financiar;</p> <p>d. një tregues të pasigurive që lidhen me shumën apo kohën e ndonjë dalje; dhe</p> <p>e. mundësinë e ndonjë rimbursimi.</p> <p>Nëse është praktikisht e pamundur për të dhënë një ose më shumë prej këtyre informacioneve shpjeguese, ky fakt duhet të deklarohet.</p>																										
46	<p>Nëse është e mundshme (ka më shumë të ngjarë se jo) një hyrje e përfitimeve ekonomike, por jo krejt e sigurtë, një njësi ekonomike do të japë një përshkrim të natyrës së aktiveve të kushtëzuara në fund të periudhës raportuese, dhe, kur praktikisht është e mundur pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, një vlerësim të efektit financiar të tyre. Nëse është praktikisht e pamundur për të dhënë këtë informacion shpjegues, ky fakt do të deklarohet.</p>																										
47	<p>Në raste shumë të rralla, nga dhënia e disa ose të gjitha informacioneve shpjeguese që kërkohen nga paragrafët 44, 45 dhe 46 mund të pritet të paragjykohet seriozisht pozicioni i njësisë ekonomike në një mosmarrëveshje me palët e tjera përsa i përket provizionit, detyrimit ose aktivitetit të kushtëzuar. Në raste të tilla, një njësi ekonomike nuk duhet të japë informacionin shpjegues, por duhet të shpjegojë natyrën e përgjithshme të mosmarrëveshjes, së bashku me faktin dhe arsyen pse nuk është dhënë informacion shpjegues.</p>																										
DATA E HYRJES NË ZBATIM																											
48	<p>Ky Standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky Standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive.</p>																										
KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (SNRF për NVM)																											
49	<p>Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë përmbajtjet e këtij Standardi me SNRF për NVM. Paragrafët janë trajtuar si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti që përshkrimet në standardet e referuara mund të kenë ndryshim.</p>																										
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Paragrafët sipas SKK 6</th> <th>Paragrafët sipas SNRF për NVM botuar në korrik 2009</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Paragrafi 1</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 2</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 3</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 4</td> <td>Sek 21.1</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 5</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 6</td> <td>Sek 21.3</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 7</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 8</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 9</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 10</td> <td>Sek 21.5</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 11</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 12</td> <td>Sek 21.6</td> </tr> </tbody> </table>	Paragrafët sipas SKK 6	Paragrafët sipas SNRF për NVM botuar në korrik 2009	Paragrafi 1	Asnjë	Paragrafi 2	Asnjë	Paragrafi 3	Asnjë	Paragrafi 4	Sek 21.1	Paragrafi 5	Asnjë	Paragrafi 6	Sek 21.3	Paragrafi 7	Asnjë	Paragrafi 8	Asnjë	Paragrafi 9	Asnjë	Paragrafi 10	Sek 21.5	Paragrafi 11	Asnjë	Paragrafi 12	Sek 21.6
Paragrafët sipas SKK 6	Paragrafët sipas SNRF për NVM botuar në korrik 2009																										
Paragrafi 1	Asnjë																										
Paragrafi 2	Asnjë																										
Paragrafi 3	Asnjë																										
Paragrafi 4	Sek 21.1																										
Paragrafi 5	Asnjë																										
Paragrafi 6	Sek 21.3																										
Paragrafi 7	Asnjë																										
Paragrafi 8	Asnjë																										
Paragrafi 9	Asnjë																										
Paragrafi 10	Sek 21.5																										
Paragrafi 11	Asnjë																										
Paragrafi 12	Sek 21.6																										

Paragrafi 13	Asnjë
Paragrafi 14	Asnjë
Paragrafi 15	Asnjë
Paragrafi 16	Asnjë
Paragrafi 17	Sek 21.7
Paragrafi 18	Sek 21.8
Paragrafi 19	Sek 21.9
Paragrafi 20	Sek 21.11
Paragrafi 21	Sek 21.10
Paragrafi 22	Asnjë
Paragrafi 23	Asnjë
Paragrafi 24	Asnjë
Paragrafi 25	Asnjë
Paragrafi 26	Asnjë
Paragrafi 27	Asnjë
Paragrafi 28	Asnjë
Paragrafi 29	Asnjë
Paragrafi 30	Asnjë
Paragrafi 31	Asnjë
Paragrafi 32	Asnjë
Paragrafi 33	Asnjë
Paragrafi 34	Asnjë
Paragrafi 35	Asnjë
Paragrafi 36	Sek 21.12
Paragrafi 37	Asnjë
Paragrafi 38	Sek 21.13
Paragrafi 39	Asnjë
Paragrafi 40	Asnjë
Paragrafi 41	Asnjë
Paragrafi 42	Asnjë
Paragrafi 43	Asnjë
Paragrafi 44	Sek 21.14
Paragrafi 45	Sek 21.15
Paragrafi 46	Sek 21.16
Paragrafi 47	Sek 21.17
Paragrafi 48	Asnjë